

Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Eurokomisionerin për zgjerim dhe politikë fqinjësore, Johanes Han



Në kuadër të vizitës në Bruksel, Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Arbër Ademi, më datë 28.09.2016 u takua me Eurokomisionerin për zgjerim dhe politikë fqinjësore, Johanes Han. Gjatë takimit u diskutua rreth më shumë temave aktuale që kanë të bëjnë me procesin e integritit evropian të vendit, në veçanti gjendjen politike, procesin zgjedhor, mbështetjen e BE-së dhe migracionin. Në këtë kontekst, Ademi informoi për realizimin e detyrimeve nga Marrëveshja e 20 korrikut që janë parakusht i rëndësishëm për organizimin e zgjedhjeve demokratike dhe të besueshme. Dy bashkëbiseduesit përshëndetën edhe vlerësimin e liderëve politik për përmbushjen e parakushteve për realizimin e zgjedhjeve në dhjetor si hap pozitiv drejt zgjidhjes së krizës politike në vend. U theksua së është e rëndësishme së veçantë që në periudhën e ardhshme, të gjithë aktorët politik, të japin kontributin e tyre për vazhdimin e procesit tonë eurointegruar. Njëherit, Komisioneri Han theksoi edhe nevojën e mbështetjes adekuate të vazhdueshme politike dhe institucionale, për punën e Prokurorës Speciale Publike.

[më shumë](#)

Zëvendëskryeministri Ademi në takim me Eduard Kukan - [më shumë](#)

Zëvendëskryeministri Arbër Ademi në vizitë pune në Bruksel - [më shumë](#)

Fjala e Zëvendëskryeministrit Ademi në konferencën e ASHAM-së - [më shumë](#)

Takim i Zëvendëskryeministrit Arbër Ademi me ambasadorin e Bashkimit Evropian në Maqedoni Samuel Zhbogar

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi, realizoi takim me ambasadorin e sapoemëruar të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, Sh.T. z. Samuel Zhbogar. Zëvendëskryeministri Ademi euro- ambasadorit të ri Zhbogar i dëshiroi realizim të suksesshëm të projekteve gjatë mandatit të tij dhe shprehu besim se bashkëpunimi i suksesshëm mes Sekretariatit për Çështje Evropiane dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme.



[më shumë](#)

Zëvendëskryeministri Arbër Ademi realizoi takim me ambasadorin e Hungarisë Laslo Ishtvan Duks - [më shumë](#)

U shënua "Dita pa makina" - [më shumë](#)


Zëvendëskryeministri kishte fjalën e tij në ngjarjen informative për hapjen e thirrjes së parë në kuadër të programit IPA 2 për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë

Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi morri pjesë në ngjarjen informative me rastin e hapjes së thirrjes së parë për propozime në kuadër të programit IPA 2 për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë në hapësirat e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shkup. Thirrja e parë për propozime në kuadër të IPA 2 programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë filloi me 16 shtator 2016 dhe shfrytëzuesit potencial nga të dy vendet do të kenë mundësi të aplikojnë me projekte të përbashkëta nga 1 nëntori 2016.



[më shumë](#)

Takime Pune



Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Sekretarin Shtetëror Dezir

Gjatë vizitës së tij në Paris, Zëvendëskryeministri përgjegjës për Çështje Evropiane Arbër Ademi realizoi takim me Sekretarin Shtetëror për Çështje Evropiane në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës, z. Arlem Dezir. Në takim, Zëvendëskryeministri iu referua gjendjes politike në vend dhe detyrimeve të cilat dalin nga marrëveshja Politike, duke theksuar vlerësimin e liderëve politik për kushtet e përmbushura për organizimin e zgjedhjeve parlamentare, si një hap pozitiv përpara. "Gjatë periudhës së ardhshme është e nevojshme të bëhen përpjekje që të organizohen zgjedhje demokratike, të besueshme dhe gjithëpërfshirëse, rezultatet e së cilave do të pranohen gjerësisht," tha Ademi dhe shtoi se për Maqedoninë është e rëndësishme së veçantë ta mbajë perspektivën evropiane

[më shumë](#)



Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me Drejtorin Danielson

Gjatë vizitës së punës në Bruksel, Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi, realizoi takim edhe me Drejtorin Gjeneral në Drejtorinë për zgjerim dhe politikë fqinjësorë në Komisionin Evropian, z. Kristijan Daniellson. Gjendja aktuale politike në vend, aktivitetet që kanë të bëjnë me organizimin e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, Reformat Urgjente Prioritare dhe IPA fondet, ishin disa nga temat që u diskutuan gjatë takimit.

[më shumë](#)

Aktivitetet e Sekretares Shtetërore Ana Blazheska



Sekretarja Shtetërore Blazheska në takim me Vinton

Sekretarja Shtetërore për Çështje Evropiane, z-nja Ana Blazheska më date 27.09.2016 realizoi takim me koordinatoren e përhershme të KB-s dhe përfaqësuesen e përhershme për UNDP në Republikën e Maqedonisë, z-nja Luiza Vinton. Në takim u diskutua gjendja e zonave që u kaplua nga vërshimet të cilat ndodhën me 6. gusht të këtij viti, si dhe statusi i përgatitjes së vlerësimeve të nevojave pas ndodhjes së fatkeqësive dhe katastrofave natyrore - PDNA

[më shumë](#)



Takimi i Sekretes Shtetërore për çështje evropiane Ana Blazhenka me ambasadorin e rendit ushtarak Sovran të Maltës Paul Gierynski

Sekretarja Shtetërore për Çështje Evropiane Ana Blazheska realizoi takim pune me ambasadorin e rendit ushtarak Sovran të Maltës, Sh.T . Paul Gierynski. Në takim ata biseduan për vazhdimësinë e procesit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë dhe implementimin e reformave prioritare urgjente, dhe u përkushtuan në situatën aktuale politiko- ekonomike në vend. Blazheska dhe Gierynski diskutuan edhe për zhvillimet e fundit lidhur me krizën e emigrantëve, veçanërisht në këtë periudhë dhe lëvizshmëria e pritshme e emigrantëve në periudhën që vijon

[më shumë](#)

Realizua prezantim i IPA-s për Sekretarë shtetëror - [më shumë](#)

Sekretarja Shtetërore Blazheska në kremtimin e ditës Botërore të instituteve "Konfucij"

[më shumë](#)

IPA Projekte

U nënshkrua Marrëveshja financiare IPA për Program aksionar shumëvjeçar për Ambientin Mjedisor dhe aksionet Klimatike dhe Transportit për vitin 2014 - 2016

Financuar nga: Bashkimi Evropian

Qëllimi i projektit: Ky program përfshinë dy sektorë të cilët janë të identifikuar në Dokumentin strategjik indikativ për Republikën e Maqedonisë për periudhën 2014 - 2020, përkatësisht të sektorit të mjedisit jetësor dhe transportit. Qëllimet e përgjithshme të asistencës nga IPA II në këtë sektor janë: Krijimi i një rrjeti rrugor modern, më të sigurt dhe ekologjik në Republikën e Maqedonisë dhe zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Prioritet do t'i jepet infrastrukturës rrugore në Observatorin e Transportit (SEETO) rrjetit të plotë të Evropës Juglindore (Korridoret VIII, X dhe ndarja xD). Ndër të tjera, nëpërmjet këtij sektori do të realizohet projekti për ndërtimin e një seksioni të ri mes Gratsko dhe Drenevo, si pjesë e rrugës Korridorit X-g. Janë parashikuar investime në tri fusha: Përafrimi i legjislacionit për mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike në fushat prioritare, investime për menaxhimin e ujit dhe mbeturinave dhe Mbështetje në zhvillim të

qëndrueshëm.

Shuma e përgjithshme : Për sektorin e mjedisit jetësor dhe aksioneve klimatike është parashikuar buxhet prej 44,365,000.00 EUR
Për sektorin e Transportit është parashikuar buxhet prej 36,906,609.70 EUR

Kohëzgjatja: 2014 - 2016

Përkrahja e USAID për Sekretariatit

Ekip i komunikimit të SÇE-së në punëtorinë për PR komunikim të brendshëm

Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE) me mbështetjen e projektit të USAID-it për përmirësimin e punës organizative (PPPO) e cila zbatohet nga qendra DETRA, me 5 dhe 6 shtator realizoi punëtorinë e parë me ekipin e komunikimit të SÇE-së. Në punëtori u prezantuan hartat e procesit dhe procedurat e PR komunikimit të brendshëm, PR doracaku ku gjithashtu u përgatit edhe plani i komunikimit e cila përmban aktivitetet e planifikuara të komunikimit të SÇE-së për periudhën tetor 2016 - tetor 2017. Nga 12 deri me 23 shtator u realizuan sesione përgatitore për përmirësimin e njohurive dhe aftësive të ekipit të komunikimit për planifikim dhe menaxhim me marrëdhënie me publikun, marrëdhëniet efektive me media dhe organizime të ngjarjeve. Gjatë muajit shtator SÇE vazhdoi me përmbledhjen e të dhënave në kuadër të sistemit të vendosur për monitorim dhe evoluim, në përputhje me planet për monitorim dhe evoluim. Ekipi i PPPO-së përgatiti mjet për analizë për të dhënat e monitorimit dhe evaluimit, e cila mundëson vendosjen e të dhënave konkrete për çdo indikator lidhur me suksesin në sistemin e monitorimit për çdo objektiv, rezultat dhe qëllimet në nivel institucional dhe sektorial. Për periudhën e ardhshme ekipi i PPPO-së do ta trajtojë udhëheqësin e njësisë për planifikim strategjik lidhur me aplikimin e mjetit për analizë të të dhënave dhe do të mbështes procesin e vendosjes të të dhënave , si dhe analizë dhe interpretimin e tyre.



BE Lajme

- [Delegacioni i Parlamentit evropian vëzhgon referendumin për marrëveshjen e paqes në Kolumbi](#)
- [ABC-ja e Parlamentit Evropian](#)
- [Këtë javë në Parlament: Llogaritë panameze, roamingu, buxheti i BE-së](#)
- [Ekonomia e Eurozonës tregoi qëndrueshmëri pas referendumin në Britani, Mario Dragi tregoi para euro deputetëve.](#)
- [Shëndeti I bimëve: Euro deputetët përkrahën marrëveshjen për bujqësi për luftën kundër fluksit të dëmtuesve në BE](#)

A e dini se ...?

- Mes shpresës dhe frikës: ardhmëria e komuniteteve hebreje në Evropë
- Fundi i roamingut: Euro deputetët po negociojnë për masa mbrojtëse për parandalimin e abuzimit

Ditët Ndërkombëtare

- 1 Tetor - Dita Ndërkombëtare e të moshuarve
- 5 Tetor - Dita Botërore e Mësuesit [UNESCO]
- 16 Tetor - Dita Botërore e Ushqimit
- 20 Tetor - Dita Botërore e Statistikës
- 31 Tetor - Dita Botërore Qyteteve

Ju Falënderojmë!